



Ref. nr. 4856/1 Prishtinë 07-12 2022

## PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

### DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti Adem Zymberi ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "Konstruksioni I lameluar i mbulesës për objekte publike afariste" në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

#### ABSTRAKT

Strukturat nga druri i lameluar përkatësisht elementet e tyre janë të lakmuara për projektimin dhe përdorimin nga Arkitektët duke pas parasysh kapacitetet e tyre mbajtëse, format arkitektonike të strukturës përkatësisht të objektit, vëllimeve të objektit, efekteve arkitektonike të tyre. Në fakt përdorimi i drurit të lameluar nënkupton në vlera minimale kufizim të projekteve të objekteve me funksione të ndryshme, forma vëllimore sisteme statike nga më të ndryshme.

Duke vlerësuar cilësitë e materialit ndërtimor, dru i lameluar atëherë përdorimi i tij në shumëllojshmëri të objekteve, del me interes edhe projektimi dhe llogaria e këtij materiali në këtë punim, për strukturën e objektit me funksion mbulesë për objekte publike afariste.

Projektimi i objekteve me funksione publike konsiderohet atraksion për Arkitektët ndërsa sfidë për strukturistët. Qasja e inxhinierit të strukturës për realizimin e projektit, paramtrat projektues, efektet e veprimeve të jashtme, lokacioni, kushtet e veçanta për objektin bëjnë përcaktimin e materialit strukturor. Në kushtet e veçanta si dhe të rëndomta mund të përdoret materiali i drurit të lameluar pa asnjë të metë dhe në raste me përparësi të shtuar.

Zhvillimi i hapësirave të mëdha drite, formësimi i gjeometrisë së elementeve strukturore, rezistencat e tyre konsiderohen përparësi e objekteve nga druri i lameluar.

Për realizimin e projektit të strukturës së veçantë, standardet e strukturave, përkatësisht gjendja kufitare janë pikënisja e hartimit të llogarisë së strukturës. Ky punim përmban rast studimor të projektimit të mbulesës nga druri i lameluar për kategori të objekteve me funksione publike. Përdorimi i standardeve Evropiane për strukturat është koncepti llogaritës, duke respektuar kërkesat e projektimit, projektimin e veprimeve të jashtme, modelimi i elementeve strukturore dhe strukturës në përgjithësi e cilësuar sistem me ramë në dy drejtime korresponduese. Normat e formimeve të strukturave të lameluara, kërkesat e veçanta për llogaritjen e elementeve strukturore duke ju dhënë gjeometri të ndryshme të jashtme dhe seksione të ndryshme tërthore.

Realizimi i lidhjeve të elementeve strukturore është sfidë për projektuesit e strukturave duke provuar që ato të jenë lehtë të realizueshme, të kenë jetëgjatësi jo më pak se jetëgjatësia e strukturës dhe në çdo moment të i mundësojnë strukturës punë të rregullt nga ajo e projektuar, pa kufizime dhe pa ndikime shtesë si rezultat i shtangimeve shtesë.

Fjalët kryesore: Druri i lameluar, skema statike, shtangimet, format gjeometrike.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.